

ALBERGO DIFFUSO KRUJA



AD Kruja ofron një përvojë të veçantë, si i pari i këtij lloji në Shqipëri dhe më gjerë në rajonin e Ballkanit. Ky model luan një rol kyç në rigjallërimin e komuniteteve lokale dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm.

Vizitorët në AD Kruja mund të përjetojnë hijeshinë autentike të qytetit, të eksplorojnë monumentet e tij historike dhe të ndërveprojnë me komunitetin vendas.

ZHVILLOJE TI
MODELIN E RADHËS
ALBERGO DIFFUSO!

Jeni të apasonuar pas ruajtjes së kulturës, promovimit të turizmit të qëndrueshëm dhe mbështetjes së ekonomisë lokale?

Keni vizionin dhe përkushtimin për të sjellë në jetë modelin Albergo Diffuso në fshatin tuaj?

Shndërroni bujtinat tuaja në modelin e radhës Albergo Diffuso!
Pasuroni përvojën turistike të komunitetit tuaj dhe sillini lagjes tuaj një frymë tjetër!

Kontakt:

AD Balkan

Zj. Brunilda Licaj, Administrator

Tel: +355 (0) 692092590

Email: info@ad-balkan.com


Web: www.ad-balkan.com

Një projekt nga Agjencia Zvicëranë për Zhvillim dhe Bashkëpunim SOC

Një partneritet me:


Zbatuar nga:

Me kontributin e:



Një koncept inovativ që synon të transformojë fshatra të braktisur dhe me potencial të pashfrytëzuar turistik, në destinacione autentike për turistët. I prezantuar fillimisht në Itali në fillim të viteve 1980, zhvilluar dhe zbatuar nga Shoqata Alberghi Diffusi (ADI).

'ALBERGHI DIFFUSI' MODELIN NË SHQIPËRI



PËRQAFIMI I TRADITËS KONCEPTI 'ALBERGO DIFFUSO'

Koncepti 'Albergo Diffuso' (AD) është krijuar nga Prof. Giancarlo Dall'Ara, për të zhvilluar turizmin në fshatrat dhe qendrat e qyteteve, duke ruajtur karakterin e tyre unik, duke garantuar harmoninë me komunitetet lokale, si dhe duke ruajtur stilin e jetës, atraksionet dhe mjedisin natyror të këtyre zonave.

Një tipar përcaktues i Albergo Diffuso - i njohur edhe si "hotel i shpërndarë" – ka të bëjë me faktin se akomodimet e ndryshme të turistëve janë të ndërthurura me shtëpitë e banimit. Kjo u jep mundësinë vizitorëve që të përjetojnë eksperiencën si banorë të përkohshëm, dhe jo thjeshtë si turistë.

KARAKTERISTIKAT E VEÇANTA TË MODELIT AD

Një menaxhim i vetëm
Shërbimet e hotelit
Shërbimet e përbashkëta
Distançë e konsiderueshme ndërmjet ndërtesave

Komunitet i gjallë
Mjedis autentik
Dallueshmëria
Turizmi i qëndrueshëm

ALBERGO DIFFUSO NË SHQIPËRI

NJË KAPITULL I RI PËR MIKPRITJEN



1170
TURISTË /
KLIJENTË

52,000 €
TË ARDHURA
NGA
SHITJET

650
DHOMA
(NETË) TË
SHITURA

17
VENDE TË
REJA PUNE

4
SHTËPI PJSË
E AD KRUJA

40%
E SHTËPIVE TË
PËRSHTATURA
NË BIZNESE
TURISTIKE

15
PARTNËRË
LOKALË

RESTORANTE,
BUTIKU, GUIDA
LOKALE, ARTIZANË,
SHOPERE


5-FISHIM
I CMIJMEVE TË
SHTËPIVE NË
FSHATIN E
VJETËR TË
KALASË

NISMA TË MUNDSHME NË SHQIPËRI

Shoqata Alberghi Diffusi ka vlerësuar potencialin e fshatrave në Shqipëri për të zbatuar modelin AD. I kryer në dy faza, në vlerësim u përfshinë 10 fshatra: Rabdisht dhe Bellovë në **Dibër**, Qytezë në **Korçë**, Leus në **Përmet**, Roshnik dhe Kalaja e Beratit në **Berat** dhe Dhoksat, Mingul dhe Pazari i Vjetër në **Tirrokastër**.

Potencial të lartë për të replikuar modelin AD kanë paraqitur **pesë fshatrat** e renditur më poshtë, së bashku me karakteristikat e tyre kryesore:

- ♦ **Bellovë, Dibër:** Mikëpritja, ndjenja e komunitetit, përkushtimi.
- ♦ **Vila Caka, Berat:** Monument kulture, ekzistenca e shtëpive tradicionale.
- ♦ **Qytezë, Korçë:** Interesi i lartë, rigjenerimi i fshatit, zhvillimi i qëndrueshëm, fshat historik.
- ♦ **Rabdisht, Dibër:** Shumëllojshmëri shërbimesh të ofruara për mysafirët, mikpritje e lartë dhe hapësirë e dedikuar muzeale, shpirt menaxhimi dhe sipërmarrës.
- ♦ **Roshnik, Berat:** Gatishmëria dhe interesi për të zhvilluar modelin AD; traditë dhe histori për të treguar.



TË ZBULOSSH KRUJËN

HISTORIKU I NJË TRANSFORMIMI TË SUKSESSHËM I MODELIT ALBERGO DIFFUSO

Në maj të vitit 2023, u shpall zyrtarisht modeli i parë 'Albergo Diffuso' në Shqipëri, **Albergo Diffuso Kruja**. I pozicionuar brenda Kalasë historike të Krujës, një kështjellë që daton në shekujt V dhe VI, ky destinacion unik përmban trembëdhjetë dhoma për vizitorët, të ndodhura në tre ndërtesa të restauruara.

AD Kruja u ofron turistëve mundësinë për të përjetuar artet dhe kulturën vendase, teksa jetojnë eksperiencën si banorë të përkohshëm.

